



Сектор за меѓународна трговска  
соработка

Sektori i Bashkëpunimit Tregtar  
Ndërkombëtar

## UDHËZIM

për zbatimin e Vendimit për kushte të veçanta për tregti me mallrave të caktuara  
(Pajisje shkollore)

Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, në seancën e mbajtur më 3 shtator të vitit 2024, miratoi Vendimin për kushte të veçanta për tregtinë e mallrave të caktuara (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 183, më 3.09. të vitit 2024), me të cilin përcakton marzhin më të lartë tregtar (fitimin) si kusht të veçantë në tregtinë me pajisje shkollore.

Marzhi më i lartë tregtar (fitimi) për mallrat e përmendura në Vendimin për të gjitha shoqëritë dhe tregtarët individualë që marrin pjesë në zinxhirin tregtar në tregtinë me shumicë është përcaktuar në vlerën e përgjithshme deri në 5%, e në tregtinë me pakicë duhet të përcaktohet në vlerën e përgjithshme deri në 10%.

Gjatë përcaktimit të çmimeve, tregtarëve, përveç marzheve të përmendura, u njihen edhe shpenzimet operative për funksionimin, të cilat duhet të shprehen qartë gjatë formimit të çmimit të shitjes për mallrat.

Kjo do të thotë që shpenzimet operative për funksionimin duhet të shprehen në një vlerë procentuale sipas Bilancit të suksesit nga viti i mëparshëm afarist, të njëjtat duhet të shpërndahen në mënyrë të barabartë për të gjitha mallrat e përmendura në Vendimin dhe përlllogaritja për formimin e çmimit të shitjes duhet të jetë pjesë përbërëse e Fletëpranimit në tregti (FPT).

Ja disa shembuj për formimin e çmimit:

### Shembull 1 - raporti i shpenzimeve – 2:1

Vlera e furnizimit të mallrave = 100 denarë

Shpenzimet operative = 50 denarë

Shpenzimet e përgjithshme = 150 denarë

Marzhi i fitimit 10% e shpenzimit të përgjithshëm = 15 denarë

Çmimi i shitjes = 165 denarë

Në këtë shembull, marzhi i fitimit bruto (MFB) do të jetë 40%, ndërsa marzhi i fitimit operativ (MFO) do të jetë 10%.

Përlllogaritja:

- Të ardhurat nga shitja	165	
Shpenzimet e produkteve të shitura	100	
Fitimi bruto	65	MFB=40%
Shpenzimet operative	50	
Fitimi operativ	15	MFO=10%



Сектор за меѓународна трговска  
соработка

Sektori i Bashkëpunimit Tregtar  
Ndërkombëtar

### Shembulli 2 - raporti i shpenzimeve 3:1

Vlera e furnizimit të mallrave = 100 denarë

Shpenzimet operative = 33.3 denarë

Shpenzimet e përgjithshme = 134 denarë

Marzhi i fitimit 10% e shpenzimit të përgjithshëm = 14 denarë

Çmimi i shitjes = 147 denarë

Në këtë shembull, marzhi i fitimit bruto (MFB) do të jetë 31%, ndërsa marzhi i fitimit operativ (MFO) do të jetë 9,5%.

Përlllogaritja:

- Të ardhurat nga shitja	147	
Shpenzimet e produkteve të shitura	100	
Fitimi bruto	47	MFB=31%
Shpenzimet operative	33	
Fitimi operativ	14	MFO =9.5%

### Shembulli 3 - raporti i shpenzimeve 4:1

Vlera e furnizimit të mallrave = 100 denarë

Shpenzimet operative = 25 denarë

Shpenzimet e përgjithshme = 125 denarë

Marzhi i fitimit 10% e shpenzimit të përgjithshëm = 12,5 denarë

Çmimi i shitjes = 137.5 denarë

Në këtë shembull, marzhi i fitimit bruto (MFB) do të jetë 27%, ndërsa marzhi i fitimit operativ (MFO) do të jetë 9,4%.

Përlllogaritja:

- Të ardhurat nga shitja	138	
Shpenzimet e produkteve të shitura	100	
Fitimi bruto	38	MFB=27%
Shpenzimet operative	25	
Fitimi operativ	13	MFO=9.4%



Сектор за меѓународна трговска  
соработка

Sektori i Bashkëpunimit Tregtar  
Ndërkombëtar

#### Shembulli 4 - raporti i shpenzimeve 5:1

Vlera e furnizimit të mallrave = 100 denarë

Shpenzimet operative = 20 denarë

Shpenzimet e përgjithshme = 120 denarë

Marzhi i fitimit 10% e shpenzimit të përgjithshëm = 12 denarë

Çmimi i shitjes = 132 denarë

Në këtë shembull, marzhi i fitimit bruto (MFB) do të jetë 24%, ndërsa marzhi i fitimit operativ (MFO) do të jetë 9%.

Përlllogaritja:

- Të ardhurat nga shitja	132	
Shpenzimet e produkteve të shitura	100	
Fitimi bruto	32	MFB=24%
Shpenzimet operative	20	
Fitimi operativ	12	MFO=9%

#### Shembulli 4 - raporti i shpenzimeve 5:1

Vlera e furnizimit të mallrave = 100 denarë

Shpenzimet operative = 67 denarë

Shpenzimet e përgjithshme = 167 denarë

Marzhi i fitimit 10% e shpenzimit të përgjithshëm = 16,7 denarë

Çmimi i shitjes = 184 denarë

Në këtë shembull, marzhi i fitimit bruto (MFB) do të jetë 45%, ndërsa marzhi i fitimit operativ (MFO) do të jetë 9,2%.

Përlllogaritja:

- Të ardhurat nga shitja	184	
Shpenzimet e produkteve të shitura	100	
Fitimi bruto	84	MFB=45%
Shpenzimet operative	67	
Fitimi operativ	17	MFO=9.2%



Сектор за меѓународна трговска  
соработка

Sektori i Bashkëpunimit Tregtar  
Ndërkombëtar

Pasi të përcaktohet çmimi i shitjes në këtë mënyrë, në fletëpranimin në tregti (FPT) do të deklarohet vlera e furnizimit të mallrave dhe vlera e shitjes së mallrave.

Përlllogaritja për përcaktimin e çmimit të shitjes duhet të jetë pjesë përbërëse e FPT-së.

Në shembujt e lartpërmendur, përdoret marzhi i fitimit prej 10% që ka të bëjë me tregtarët me pakicë.

Përlllogaritjen e njëjtë mund ta përdorin tregtarët me shumicë, me atë që marzhi i fitimit duhet të arrijë 5%.

Nëse keni pyetje plotësuese, mund të telefononi në kontaktin e mëposhtëm 02/3093473 dhe 02/3093538.